



Viti 2014 do të jetë një vit elektoral, zgjedhesh dhe zgjidhesh për të ardhmen. Në FSHF, do të garohet për vendin e presidentit por dhe për poste të tjera drejtuese. Disa muaj përpara përcaktimit se cili do të jetë drejtuesi i Federatës Shqiptare të Futbollit, ka nisur të flitet shumë për këte çështje në ambiente të ndryshme sportive.

Kandidati kryesor padyshim pritet të jetë Presidenti aktual i kësaj Federate, Armand Duka, për të cilin do të jetë mandate i katërt nëse vendos që do të konkurrojë për të mbajtur postin që ka

“Akoma nuk kam vendosur nëse do të garoj në zgjedhjet e reja, por mund të them se me shumë jam me dëshirën pozitive për të konkurruar perseri, por ka akoma kohë për të marrë vendimin përfundimtar”, shpjegoi për Albaniasoccer.com, Presidenti aktual i FSHF-se, Armand Duka i cili mesa duket do të konkurrojë i vetëm dhe pa kundërshtarë në zgjedhjet e reja. Shumë candidate janë përfolur por asnjë nuk e merr persiper të garojë, duke patur parasysh përfundimin e zgjedhjeve në 3 mandatet e fundit, kur Duka ka fituar bindshëm.

Njeri prej emrave më të përfolur në mediat vendase ishte ai i Iglit Tares, ish kapitenit të skuadës kombëtare dhe aktualisht Drejtor Teknik të klubit Italian i Serie A, SS Lazio.

“Jo, nuk është aspak e vertete që kam ndermend të hedh kandidaturën për President i FSHF-se”, u shpreh Iglit Tare Ekskluzivisht për Albaniasoccer.com. “Jane komplet fjale të gabuara ato që fliten pasi unë nuk kam këte lloj ambicijeje”, vazhdoi Iglit prononcimin e tij duke hedhur poshtë thashethemet që qarkullonin nëpër mediat sportive.

## **Ekskluzive / Tare thote "JO" - Duka thujse "PO"!**

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 18 Shtator 2013 05:48

---

Me me shume "PO" per Duken dhe me komplet "JO" per Taren, fushata elektorale per zgjedhjen e Presidentit te ri te FSHF-se pritet te jete nje dominim i plote i Dukes, ndonese ashtu sic dihet dhe ashtu sic e pohoi vete numri "1" i futbollit shqiptar - ka akoma kohe .....